



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE  
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA  
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

**VENDIM**

**Nr.54, datë 20.12.2024**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME VORË SH.A.**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (**VKM nr.958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

**Komisioni Kombëtar Rregullator,**

në mbledhjen e datës 20.12.2024 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit "Për licencimin e shoqërisë Ujësajllës Kanalizime Vorë sh.a.",

**Konstaton se:**

1. Shoqëria Ujësajllës Kanalizime Vorë (UK Vorë) me shkresën nr. prot 425 datë 11.11.2024, me lëndë "Kërkesë për pajisje me licencë" ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për rinovim licence për shkak të mbarimit të afatit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Vorë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM nr. 63 datë 27.01.2016 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet

juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

- a) Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Vorë sh.a (NUIS L62017028A) është themeluar më datë 05.08.2016, me aksionarë Bashkia Vorë me 100 %.
- b) Drejtuesja teknike e shoqërisë UK Vorë, Znj. Majlinda Bylykbashi, është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega Ndërtim, në vitin 1991, plotëson kërkesat e VKM nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.
- c) Shoqëria UK Vorë sh.a deklaron se ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për **40,897** banorë të Bashkisë Vorë.

4. ERRU në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Vorë, të:

- a) Kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjiellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;
- b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar, (**ligji nr. 9121**) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Vorë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

#### **VENDOSI:**

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Vorë sh.a me (NUIS L62017028A), në kategoritë:
  - a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
  - b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura,
2. Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Vorë sh.a autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:
  - a) Drejtues Ligjor – Ivi Koja

- b) Drejtues Teknik – Majlinda Bylykbashi
3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Vorë sh.a është Bashkia Vorë.
  4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 vjeçare.
  5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Vorë sh.a detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
  6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Vorë sh.a për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYETARE**

**EVIS SHURDHA**